



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:284399

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05501672

C.nr.1744/22

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.E., R.E., S.B., B.E., dhe F.E., që të gjithë nga fshati ..., komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Rexhep Kabashi, avokat në Prizren, kundër të paditurit K.N., nga fshati ..., komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bardh Maksuti, avokat në Gjakovë, me objekt kontesti kthimi i borxhit, vlera e objektit të kontestit 29,094.65 euro, jashtë seance, me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET poshtë si e pa lejueshme padia e evidentuar me numër C.nr.1744/22, e datës 13.02.2015, e paditësve N.E., R.E., S.B., B.E., dhe F.E.,, që të gjithë nga fshati Nagavc, komuna e Rahovecit, kundër të paditurit K.N., nga fshati ..., komuna e Gjakovës, me bazë juridike kthim borxhi, vlera e objektit të kontestit 29,094.65 euro, për shkak të ekzistimit të gjyqvarësisë.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Fillimisht paditësi S.E., në këtë gjykatë me datë 12.02.2015 kishte paraqitur padi kundër të paditurit K.E., me objekt kontesti kthimi i borxhit.

Gjykata, përmes Aktvendimit C.nr.1057/2019, të datës 22.01.2020 ka ndërprerë procedurën kontestimore lidhur me këtë çështje për shkak të vdekjes së paditësit përgjatë procedurës.

Trashëgimtarët e paditësit me datë 22.11.2022, kanë paraqitur kërkesë për vazhdim të procedurës, e që gjykata e çështjes pasi ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për vazhdim të procedurës, me datë 10.11.2023 ka marrë aktvendim për vazhdim të procedurës ku procedura do vazhdonte me trashëgimtarët e S,E, përkatësisht më tashmë paditësit N.E., R.E., S.B .B.E., dhe F.E.,.

Gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës dhe bazuar edhe në udhëzimet e Gjykatës së Apelit të dhëna në Aktvendimin Ac.nr.4459/15, rreth faktit nëse kemi të bëjmë me gjyqëvarësi dhe se çfarë ka ndodhur me padinë C.nr. 634/06, të datës 16.10.2006, lëndë e cila është pjesë e shkresave të lëndës C.nr.1744/22, gjeti se në këtë gjykatë është duke u zhvilluar edhe një procedurë kontestimore nën shenjë C.nr.634/06 në mes të palëve të njëjta me objekt të njëjte kontesti. Paditësi S.E., në Gjykatën Komunale në Gjakovë me datë 16.10.2006 ka paraqitur

padi ndaj të paditurit N.N., emrin e të cilit, sipas vendimit të kësaj gjykate, e kishte përmirësuar me parashtrësën e datës 09.10.2012, si K.N., pranë kësaj gjykate me datë 01.11.2012 ka paraqitur përgjigje në padi, dhe përmes të të autorizuarit të tij, ka marrë pjesë si palë e paditur në katër seanca gjyqësore. Ndërsa gjykata me datë 31.10.2014 kishte vlerësuar përsëri parashtrësën e datës 09.10.2012 të paditësit, dhe me datë 31.10.2014 kishte marrë Aktvendim C.nr. 634/06, duke e refuzuar propozimin e paditësit S.E., lidhur me zgjerimin e padisë në kuptim subjektiv “kundër të paditurit të ri” K.N., në këtë çështje juridike.

Rrjedhimisht, procedura në çështjen kontestimore të evidentuar me numër C.nr. 634/06, nuk ka përfunduar me asnjë vendim gjyqësor, kjo për faktin se vendimi i datës 31.10.2014 ku është refuzuar precizimi (përmirësimi) i padisë së paditësit është vendim procedural, nga çka rezulton se e njëjta nuk ka marrë epilog përfundimtar nga ana e gjykatës.

Në nenin 262 paragrafi 1 të LPK-së është paraparë që “Gjyqvarësia krijohet që në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia”, e që rastin konkret, i padituri ka dhënë përgjigje në padi me datë 01.11.2022, andaj kjo gjykatë vlerëson se gjyqëvarësia është krijuar në lëndën C.nr.634/06 e paraqitur në ish Gjykatën Komunale në Gjakovë.

Në nenin 262 paragrafi 3 të LPK-së parashihet që “Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata e hedhë poshtë padinë”, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni thuhet se “Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta. Andaj për faktin se gjykata konstatoj se në lëndën C.nr. 634/06 është krijuar gjyqëvarësia, me qëllim të evitimit të zhvillimit të dy proceseve gjyqësore mes palëve të njëjta, për çështjen e njëjtë, bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata vendosi si në pikë I të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e hedh padinë e paditëses.

Nga të lartcekurat, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet vendosi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1744/22, datë 25.03.2024

Gjyqtarja,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.